



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1.24.

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr.752/1prot.

Elbasan, më 05.04.2020

VENDIM

Nr. 16 datë 05.04.2020

**"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
SË FUNKSIONIMIT TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma "d", Statutit të UE-së, neni 9, gërma "d", Senati Akademik më datë 05.04.2020

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Rektori dhe anëtarët e Senatit Akademik me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

RREGULLORE

E

**FUNKSIONIMIT TË SENATIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"**

PRILL 2020



NENI 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për funksionimin e Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (më poshtë UE) dhe marrëdhëniet e tij me strukturat e tjera të UE-së.

NENI 2

Përkufizimi

Senati Akademik është organi më i lartë drejtues akademik i UE-së.

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.

NENI 3

Përbërja e Senatit Akademik

1. Senati Akademik i UE-së përbëhet nga 23 (njëzet e tre) anëtarë. Njësitë kryesore përfaqësohen në Senat me nga 4 (katër) anëtarë.
2. Senati kryesohet nga Rektori.
3. Anëtarët e Senatit Akademik të UE-së zgjidhen nga asamblatë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
4. Anëtarët e Senatit Akademik në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të kandidaturave me këtë titull dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë deri në gradën shkencore "Doktor" të fituar pranë universiteteve brenda vendit.
5. Në Senatin Akademik të UE-së përfaqësohen edhe studentët, në masën 10% (dhjetë përqind).



NENI 4

Funksionet e Senatit Akademik

Senati Akademik i UE-së ushtron këto funksione:

1. Garanton autonominë e UE-së, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
2. I propozon Bordit të Administrimit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
3. Miraton statutin e UE-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
4. Miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të tij;
5. Miraton rregulloret e institucionit, përveç atyre që janë kompetencë e Bordit të Administrimit;
6. Miraton marrëveshjet apo memorandumet e bashkëpunimit;
7. Miraton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
8. Miraton procedurat për punësimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik;
9. I propozon Bordit të Administrimit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
10. Miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
11. Miraton numrin e studentëve për çdo program studimi;
12. Miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi;
13. Propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
14. Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
15. Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
16. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
17. Zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
18. Miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
19. Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;
20. Miraton mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
21. Krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në statut;
22. Organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;



23. Akordon tituj honorifikë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

NENI 5

Kryetari i Senatit Akademik

Senati kryesohet nga Rektori.

Kryetari i Senatit Akademik ushtron këto funksione:

1. Shpall rendin e ditës dhe njofton zyrtarisht strukturat përkatëse të UE-së për paraqitjen e materialeve sipas tematikës së caktuar.
2. Thërret mbledhjen e Senatit Akademik në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore.
3. Drejton mbledhjen e Senatit Akademik dhe siguron zbatimin e kuadrit ligjor në procesin e vendimmarrjes.
4. Nënshkruan aktet që miraton Senati Akademik.

NENI 6

Komisionet e Senatit Akademik

Për të lehtësuar funksionimin e brendshëm si dhe për vlerësimin paraprak të propozimeve që i paraqiten atij, Senati Akademik krijon komisionet e mëposhtme:

- a. Komisioni i punës mësimore
- b. Komisioni i punës kërkimore shkencore
- c. Komisioni politikave të zhvillimit e akreditimit
- d. Komisioni i buxhetit dhe investimeve
- e. Komisioni i marrëdhënieve me jashtë

Në përbërje të këtyre komisioneve janë anëtarët e Senatit Akademik.

Detyrat e anëtarëve të komisioneve përputhen me misionin që ka secili komision, sipas fushës që mbulon.

NENI 7

Sekretari administrativ

1. Sekretari administrativ i Senatit Akademik caktohet nga Senati Akademik dhe është pjesë e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e UE-së.
2. Sekretari administrativ i Senatit Akademik kryen këto detyra:
 - a) Njofton zhvillimin e mbledhjes së Senatit Akademik.
 - b) Njofton Kryetarin e Senatit Akademik për pjesmarrjen e anëtarëve në mbledhje.
 - c) Mban procesverbalin e mbledhjes së Senatit Akademik.



- d) Administrojnë dhe ruajnë dokumentat zyrtare të Senatit Akademik.
- e) Kryejnë çdo funksion tjetër që i caktohet nga Senati Akademik në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje.

NENI 8

Mbledhjet e Senatit Akademik

1. Senati Akademik mbledhet periodikisht.
2. Kryetari i Senatit përcakton rendin e ditës dhe vendos për thirrjen e mbledhjes së Senatit Akademik.
3. Njoftimi i mbledhjes, i komunikohet anëtarëve të Senatit Akademik, pasi janë shprehur komisionet dhe të paktën 5 ditë kalendrike përpara datës së caktuar për mbledhjen. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe datën e zhvillimit të mbledhjes, si dhe duhet të shoqërohet me projekt vendimet dhe materialin argumentues. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes iu komunikohet anëtarëve të Senatit Akademik në mënyrë elektronike nga sekretari administrativ.
4. Senati mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme për çështje emergjente. Në këtë rast njoftimi dhe materialet shoqëruese të nevojshme për vendimmarrje do t'i dërgohen anëtarëve të paktën 24 orë para mbledhjes së Senatit Akademik.
5. Senati Akademik mund të mbledhet në seanca të jashtëzakonshme, me iniciativën e kryetarit të Senatit Akademik ose me kërkesën e një të tretës të anëtarëve të tij. Në rastin kur Senati Akademik mbledhet me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij, rendi i ditës propozohet nga grupi i anëtarëve propozues.
6. Diskutimet e zhvilluara dhe vendimmarrja pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Senatit dhe sekretari administrativ.
7. Si rregull mbledhjet e Senatit Akademik zhvillohen në ambientet e UE-së. Në rast se mbledhjet mbahen në një vend tjetër, ky fakt evidentohet në njoftimin e mbledhjes.
8. Përrjashtimisht, në raste të veçanta, kur për arsye të justifikuara është e pamundur që mbledhja e Senatit Akademik të zhvillohet me pjesëmarrjen fizike të anëtarëve të tij, anëtarët e Senatit Akademik do të shprehin mendimet, sugjerimet dhe votën e tyre në rrugë elektronike, përmes postës elektronike zyrtare. Në këtë rast, vendimmarrja e Senatit Akademik do t'iu njoftohet anëtarëve në mbledhjen e radhës dhe ky fakt do të pasqyrohet në proces verbalin përkatës.



NENI 9

Materialet që do të shqyrtohen në mbledhjen e Senatit Akademik depozitohen në Rektoratin e UE-së.

Materialet që paraqiten për shqyrtim në Senatin Akademik, vlerësohen paraprakisht nga personeli teknik i Rektoratit dhe Komisionet e Senatit Akademik, të cilët i shprehin Senatit me shkrim vlerësimin e tyre.

Në rast se Komisioni nuk bie dakord me një material të caktuar, ka të drejtë ta kthejë atë për ripunim.

NENI 10

Kuorumi

Si rregull, mbledhjet e Senatit Akademik janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij.

Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 ore pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme nëqoftëse janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

NENI 11

VENDIMMARRJA

Si rregull, Senati Akademik i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishmëm në mbledhje, përveç rasteve kur në aktet ligjore apo nënligjore përcaktohet ndryshe. Votimet në Senatin Akademik bëhen të hapura.

Votimet në Senatin Akademik mund të bëhen të fshehta kur kjo kërkohet nga kryetari i Senatit ose nga një e treta e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

NENI 12

Zbardhja e Vendimeve

Vendimet e Senatit Akademik zbardhen brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

Vendimet e Senatit Akademik nënshkruhen nga kryetari i tij dhe bëhen publike në faqen elektronike zyrtare të UE-së, si dhe në faqet e tjera elektronike të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të fuqi.



Një kopje e vendimit i dërgohet njësisë/njësive përkatëse për zbatim.

Vendimet e Senatit Akademik arkivohen dhe ruhen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

NENI 13

Mbarimi dhe ndërprerja e mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

Anëtarët e Senatit Akademik të institucioneve të arsimit të lartë zgjidhen nga asambltë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar.

Mandati i anëtarit të Senatit ndërpritet, përara përfundimit të mandatit katërvjeçar, kur:

- jep dorëheqjen;
- largohet nga UE;
- bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
- nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
- kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Vendi i mbetur vakant plotësohet nga kandidati pasardhës në renditje.

NENI 16

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 16, datë 05.04. 2020

